



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komititet për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

23	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	19.12.2019, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lart për Punë Profesionale të Kuvendit
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Eliot Kukiqi, Ajshe Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Nënkryetari i Komunës z. Agim Ademaj, Edona Bujupi-Loxha, Lulzim Blakaj, Enver Rugova, Jashar Blakaj, Drin Sadikaj, Hysni Maxharri, Hysen Pelaj, Lulzim Shoshi, Jeta Balaj-Imeraj, Fjollë Berisha.
Rendi i ditës:	
<ol style="list-style-type: none">1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba,3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës KKSBB për vitin 2020,4. Marrja e Vendimi për zëvendësimin e anëtareve të KKSBB-së5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi z. Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Propozon pikë shtesë të Rendit të ditës Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, fjalën ja kalon z. Isa Hoxha zyrtar i lartë për Energji dhe Eficenc,</p> <p>Isa Hoxha - prezanton dhe sqaron Plani Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, dhe kërkon që të jetë pikë e rendit të ditës.</p> <p>Zenel Shatri - pyete nëse jeni vonuar me këtë planë, apo pse është e gjithë kjo nguti.</p> <p>Isa Hoxha - duhet të miratohet në vitin 2019 sepse plani është punuar gjatë vitit 2019 dhe të gjitha të dhënat janë që nga viti 2019 dhe Plani është i parapara për vitin 2019-2021.</p> <p>Haki Podrimaj - drejtori e sqaroi ta shtojmë në rend të ditës dhe ta kalojmë këtë planë.</p>	

Nënkryetari – duhet të miratohet po në këtë vite sepse është punuar për vitet 2019-2021.
Eliot Kukiqi – pajtohem me doktorin si qëndron puna a jen vonuar me këtë planë.
Ajshe Metaj – i mbështes Doktorin dhe me Eliotin, nuk është e arsyeshme që ne të ngutemi.
Kryesuesi – hedh në miratim kush është që kjo pikë të hy si pikë e rendit të ditës dhe ti kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim, kjo pikë e rendit të ditës,
Plani Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021
Miratohet me 6 vota për dhe 1 kundër.

Pyet nëse ka dikush diçka tjetër para miratimit të rendit të ditës.

Ajshe Metaj – propozon që Strategjia e GGA-së 2020-2023 të hy si pik e rendit të ditës

Kryesuesi - Hedh në miratim Strategjinë e GGA-së 2020-2023, me kushte qe të kompletohet materiali dhe të sille për mbledhjen e KK.

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së

Pasi që nuk ka diskutime tjera hedh në miratim rendin e ditës me këto propozime.

Rendi i ditës me këto propozime miratohet me 6 vota për dhe 1 kundër

Vendimet:

Miratohet njëzëri rendi i ditës, me këto ndryshime të lartcekura.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.

Pasi që diskutime nuk pat hedh në miratim.

Vendimet:

Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.

Personat përgjegjës për zbatim:

Afati për zbatim:

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba, Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën ja kaloi Drejtorit për Buxhet dhe Financa, z . Hysni Maxharraj

Hysni Maxharraj - prezantoi Draft - Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba,

Lulzim Blakaj, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik – sqaron përputhjet e kësaj Rregullore me Rregulloret e tjera në fuqi.

Kryesuesi – kërkon nga ju drejtor që këtë draft që ju po e prezantoni të na dërgoni për mbledhjen e Kuvendit pasi që anëtarët e KPF-së nuk e kanë të njëjtin material.

Ajshe Metaj – të punohet kjo Rregullore mirë qe mos të na kthehet në rishqyrtim.

Propozon që në këtë Rregullore të hy dita e diele ditë pushimi për të gjithë.

Lulzim Blakaj – znj. Ajshe Rregullorja për orarin e punës të hoteleve afariste, ku keni mundur ta propozoni që dita e diel të jetë ditë pushimi në k. Istog është miratuar me herët, kjo është rregullore për taksa, dhe nuk mund të hy propozimi yt këtu.

Eliot Kukiqi – propozon që në këtë rregullore të përfshihen lirimi i familjarëve të veteranëve jo vete veteranit por edhe të familjarëve të tyre.

Hysni Maxharraj – për këtë do të konsultohemi me zyrtaren ligjore ashtu siç ceket me ligj do ta kemi edhe në këtë rregullore, në mbledhjen e kuvendit do te keni një përgjigje për ju.

Kryesuesi, a ka dikush tjetër diqka.

Pasi që diskutime tjera nuk ka atehere kush është që t'i rekomadohet KK-së për shqyrtim dhe miratim:

Unanim miratohet nga anëtarët e KPF-së.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim kalon: Draft – Rregulloren për taksë ngarkesa dhe gjoba, të njëjti ia kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës KKSB,, si dhe orari i mbajtjes së takimeve të KK dhe KPF-së. Fjalën ia kalon Nënkryetarit

Nënkryetari - prezenton dhe sqaron Planin e punës së KKSB,

Ajshe Metaj – ky planë është i mirë, por qfarë po bëhet me qent endacak, e dim që është një shtepi për grumbullimin e tyre.

Eliot Kukiqi – propozoj që si pik e rendit të ditës në kete planë të hy: Rrenimi i objekteve të vjetra qe rrezikojn mirqenjen e qytetarve.

Kryesuesi – hedh në miratim propozimin e Eliotit,

Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,

Hedhe në votim Planin e punës me këtë propozim

Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Planin e punës së KKSB, si dhe e njejta i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e katërt e rendit të ditës: Marrja e Vendimi për zëvendësimin e anëtareve të KKSB-së,

Nënkryetari – bënë prezantimin dhe sqarimin e propozimit për marrja së Vendimi për zëvendësimin e anëtareve të KKSB-së

Zenel Shatri - për këta persona të shkruhet një biografi e shkurtër

<p>Kryesuesi pasi që diskutime tjera nuk ka hedh ne votim, Në menyerë unanime nga anëtarët e KPF-së i kalohet KK për miratim kjo pikë e rendit të ditës.</p>	
Vendimet:	
<p>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Marrja e Vendimi për zëvendësimin e anëtareve të KKSB-së, dhe e njëjta i kalohet Kuvendit të komunës-së për shqyrtim dhe miratim.</p>	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 5.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e pestë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme, Jashar Blakaj, Drejtor për Kadaster dhe Gjeodezi - prezanton, Propozim Vendimet e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme Nënkryetari - sqaron Propozimi - Vendimet Nr.982/019 dhe 989/019. Kryesuesi - hedhe në votim propozim vendimi Nr.982/019 dhe 989/019 anëtarët e KPF-së unanim miratoj këto propozim vendime. Dhe në miratim Propozim - Vendimin Nr.995/019 anëtarët e KPF-së unanim miratojnë këtë propozim Vendim.</p>	
Vendimet:	
<p>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Shqyrtimin dhe miratimin e Propozim Vendimeve të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme, dhe e njëjta i kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.</p>	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 6.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e gjashtë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Komunal të Veprimit për Efiçencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, Isa Hoxha, zyrtar i lartë për Energji dhe Eficenc - prezanton dhe sqaron Planit Komunal të Veprimit për Efiçencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, Kryesuesi - pasi diskutimet përfunduan me propozimin e kësaj pike dhe ska të lajmeruar për diskutim, hedh në votim.</p>	
Vendimet:	
<p>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF me 5 vota për dhe dy kunder rekomandon: Shqyrtimin dhe miratimin i Planit Komunal të Veprimit për Efiçencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, dhe e njëjta i kalohet KK-së për rishqyrtim dhe miratim.</p>	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 7.	

Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, po vazhdojmë më pikën e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjis së GGA-së 2020-2023, kjo pikë mbet të hy si pik e rendit të ditën në mbledhjen e KK nese kompletohet materiali dhe strategjia të jetë e gatshme të dergohet me material.</p>	
Vendimet:	
<p>Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjis së GGA-së 2020-2023, dhe e njëjta i kalohet KK-së për rishqyrtim dhe miratim.</p>	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
<p>Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë dhe shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.</p>	
Mbledhja përfundoj :	12:10